

RELACION SHPJEGUES

MBI

PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.459, DATË 30.7.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RAJONEVE TË ZHVILLIMIT DHE KUFIJVE TË TYRE”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Në përputhje me ligjin nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, ndarja e rajoneve zhvillimore dhe kufijve të tyre mbështetet në disa kriterë kyçë, si vendndodhja dhe pozicioni gjeografik, karakteristikat e zhvillimit socio-ekonomik, numri i popullsisë dhe perspektiva e zhvillimit ekonomik të çdo rajoni. Kjo ndarje mbështet zhvillimin e politikave të specializuara për të adresuar nevojat dhe mundësitë e secilit rajon, duke kontribuar kështu në një rritje të kohezionit dhe të ndihmës për rajonet më të disavantazuara.

Projektvendimi i propozuar ka për qëllim bërjen e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin bazë të këshillit të ministrave në fuqi për ndarjen e rajoneve zhvillimore dhe kufijve të tyre, si një nga aspektet kyçë për zhvillimin e qëndrueshëm rajonal dhe arritjen e sinergjisë, ndërveprimit dhe kohezionit në nivel kombëtar. Rishikimi dhe ripërcaktimi i kufijve të rajoneve zhvillimore është i nevojshëm për të siguruar që strategjitë dhe politikat e zhvillimit të jenë në përputhje me dinamikën e reja socio-ekonomike dhe demografike. Për sa më sipër ndryshimi i propozuar i ndarjes territoriale nuk është thjesht një përpjekje për të riparuar një ndarje të vjetër, por një

mundësi për të krijuar një strukturë më të balancuar dhe më efikase, që mbështet zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të vendit.

II. VLERËSIM I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA.

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të miratuar për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME.

Në vijim të zbatimit të reformës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit që kulmoi me miratimin e ligjit Nr.102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin” si dhe të dinamikave të zhvillimit të rajoneve dhe territoreve të Shqipërisë, rishikimi i kufijve ekzistues të rajoneve të zhvillimit përbën një domosdoshmëri strategjike të lidhur me nevojën për transformim të qasjes ndaj zhvillimit rajonal e territorial në vend.

Kjo qasje shënon një zhvendosje nga modeli ekzistues, i cili fokusohet vetëm në reduktimin e pabarazive territoriale dhe një zhvillim të balancuar në mënyrë lineare, drejt një modeli më dinamik dhe funksional. Sipas kësaj paradigme, territori nuk trajtohet më si një hapësirë homogjene që thjesht duhet niveluar, por si një sistem kompleks me potenciale të diferencuara që kërkojnë trajtim të diferencuar. Kjo qasje e re e vendos theksin mbi profilizimin funksional të rajoneve, mbi identifikimin dhe zhvillimin e avantazheve krahasuese të secilit territor, duke nxitur specializimin ekonomik, institucional dhe social të tyre. Ajo synon të krijojë rajone që nuk konkurrojnë në mënyrë të panevojshme për të njëjtat burime dhe sektorë, por që

ndërtojnë marrëdhënie komplementare dhe sinergjike mes tyre, duke rritur eficiencën e përgjithshme të ekonomisë kombëtare dhe duke forcuar kohezionin përmes ndërvarësisë funksionale. Synimi është që rajonet të mos jenë thjesht një grupim i njësisë të vetëqeverisjes vendore, por reflektim i sistemeve reale të ndërveprimit territorial. Në këtë mënyrë mund të ndërtohet një arkitekturë rajonale që i përgjigjet sfidave aktuale dhe krijon bazën për një zhvillim më inteligjent, më konkurrues dhe më të qëndrueshëm në afatgjatë.

Nevoja për rishikimin e ndarjes së Rajoneve Zhvillimore lidhet gjithashtu edhe me ndryshimet e rëndësishme demografike dhe socio-ekonomike të evidentuara nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2023, si dhe me analizat territoriale të realizuara gjatë vitit 2025, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”. Të dhënat e Censurit 2023 ofrojnë një pasqyrë të përditësuar të shpërndarjes së popullsisë dhe të dinamikave të zhvillimit ekonomik në territor, duke evidentuar ndryshime të rëndësishme në strukturën demografike dhe në potencialin zhvillimor të rajoneve. Lëvizjet e popullsisë, urbanizimi i përshpejtuar, tkurrja demografike në disa zona dhe rritja e përqendrimit në të tjera kanë krijuar realitete të reja territoriale që nuk përputhen më me ndarjet ekzistuese rajonale. Paralelisht, transformimet në strukturën ekonomike, zhvendosja e aktiviteteve drejt sektorëve të shërbimeve, zhvillimi i poleve të reja ekonomike apo rënia relative e disa aktiviteteve tradicionale, kërkojnë një riorganizim të hapësirës zhvillimore që të pasqyrojë më mirë këto dinamika. Në këtë kontekst, kufijtë aktualë të rajoneve zhvillimore nuk pasqyrojnë më në mënyrë të plotë realitetin aktual territorial dhe zhvillimor, duke krijuar nevojën për rishikimin dhe rikonfigurimin e rajoneve dhe kufijve të tyre. Një hartë rajonale që nuk reflekton këto ndryshime mund të prodhojë politika të paefektshme, shpërndarje jo optimale të burimeve dhe ndërhyrje që nuk adresojnë nevojat reale të territorit.

Në përputhje me ligjin nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, ndarja e rajoneve zhvillimore duhet të mbështetet në një sërë kriteresh, të cilat përfshijnë vendodhjen dhe pozicionin gjeografik, karakteristikat e zhvillimit socio-ekonomik, numrin e popullsisë dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të territoreve përkatëse. Rajonet zhvillimore, në konfigurimin më të përshtatshëm të tyre konceptohen si

rajone funksionale, të cilat ndërtohen mbi ndërveprimin e faktorëve gjeografikë, ekonomikë, socialë dhe infrastrukturorë, si dhe mbi marrëdhëniet funksionale ndërmjet territoreve që i përbëjnë ato. Në këtë kuptim, ndarja rajonale nuk bazohet vetëm në kritere tradicionale administrative apo historike, por në identifikimin e hapësirave territoriale që funksionojnë si njësi të integruara zhvillimi, duke mundësuar ndërlidhjen më të mirë të karakteristikave të ngjashme dhe përplotësuese ndërmjet territoreve, me synim krijimin e rajoneve me profil të qartë funksional. Kjo do të thotë se organizimi rajonal nuk synon vetëm grupimin territorial në bazë afërsie, por ndërtimin e njërive që mbështesin profilizimin zhvillimor, diferencimin funksional komplementar dhe planifikimin e zhvillimit rajonal dhe kohezionit mbi baza më të qëndrueshme e më efikase.

Analiza e zhvillimit territorial dhe e treguesve demografikë tregon se disa nga kriteret e shqyrtuar, veçanërisht ato që lidhen me numrin e popullsisë dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik, kanë pësuar ndryshime të dukshme brenda Rajonit të Zhvillimit 2. Censusi 2023 evidenton një rritje të popullsisë në zonën e Tiranës, ndërkohë që pjesë të tjera të territorit, veçanërisht zonat malore dhe periferike, kanë shënuar rënie të popullsisë. Ky zhvillim ka krijuar një realitet të ri territorial, ku zona metropolitane e Tiranës paraqet një nivel më të lartë përqendrimi demografik dhe një dinamikë më të theksuar zhvillimi ekonomik krahasuar me pjesët e tjera të rajonit.

Në të njëjtën kohë, zhvillimet e viteve të fundit tregojnë një rritje të ndjeshme të aktivitetit ekonomik në sektorë të tillë si ndërtimi, shërbimet dhe turizmi, të cilët kanë një përqendrim të veçantë në zonën metropolitane të Tiranës. Kjo dinamikë krijon një profil zhvillimor të diferencuar brenda Rajonit të Zhvillimit 2, duke e bërë të nevojshëm rishikimin e mënyrës së trajtimit dhe analizës së kësaj hapësire nga këndvështrimi i zhvillimit rajonal, jo vetëm për të reflektuar më saktë peshën demografike dhe ekonomike të territoreve përbërëse, por edhe për të mbështetur organizimin funksional të territorit. Në këtë kuptim, rikonfigurimi i rajonit krijon kushte më të mira për hartimin e strategjive dhe planeve zhvillimore të targetuara që konsiderojnë siç duhet potencialet dhe sfidat e dallueshme që paraqesin hapësirat urbane, periurbane dhe rurale duke i kushtuar vëmendjen e duhur edhe pabarazive

brenda-rajonale. Riroganizimi i kufijve të Rajonit të Zhvillimit 2 gjithashtu mundëson ndjekjen e qasjes së specializimit inteligjent të territorit (SMART specialization) të mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Politika e Kohezionit, duke identifikuar më qartë karakteristikat në territor, potencialet përkatëse dhe rolet komplementare të territoreve përbërëse.

Në këtë kuadër, propozohet rikonfigurimi i Rajonit të Zhvillimit 2, i cili do të përfshijë territoret e qarqeve Dibër, Tiranë, Durrës dhe Elbasan, ndërsa brenda tij identifikohen si zonë me karakter të veçantë metropol territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë Tiranë dhe Kamëz, për shkak të rolit të tyre në strukturën demografike dhe ekonomike të vendit. Gjithashtu, bazuar në analizën e profilit socio-ekonomik, kulturor dhe të lidhjeve logjistike ndërmjet territoreve, propozohet që qarku i Elbasanit të përfshihet në Rajonin e Zhvillimit 2, ndërsa qarku i Gjirokastrës të riorientohet në Rajonin e Zhvillimit 3, duke reflektuar më mirë lidhjet funksionale dhe potencialin zhvillimor të këtyre territoreve, si edhe duke krijuar një bazë më të përshtatshme për diferencim funksional komplementar ndërmjet rajoneve. Ky riorganizim synon që çdo rajon të ketë një kombinim më koherent karakteristikash zhvillimore, burimesh, lidhjesh ekonomike e logjistike dhe kohezioni funksional territorial, në mënyrë që rajonet të mos jenë vetëm njësi statistikore apo administrative, por hapësira reale për ndërtimin e profileve funksionale të dallueshme dhe plotësuese me njëra-tjetrën.

Rishikimi i ndarjes së rajoneve zhvillimore synon gjithashtu të sigurojë një përputhje më të mirë me qasjet dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushën e kohezionit rajonal, duke krijuar kushte për përdorimin më efikas të instrumenteve të financimit dhe për planifikimin më të integruar të zhvillimit territorial në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, kjo qasje mbështet hartimin e strategjive rajonale më të orientuara drejt specializimit inteligjent, ku prioritetet e zhvillimit përcaktohen jo vetëm mbi bazën e nevojës për ekuilibrim territorial, por edhe mbi bazën e potencialeve të veçanta, funksioneve ekonomike dhe rolit komplementar që secili rajon mund të luajë në strukturën e përgjithshme të zhvillimit të vendit.

Në përfundim, ndryshimi i propozuar synon krijimin e një strukture rajonale më funksionale, me një balancë më të arsyeshme territoriale, por mbi të gjitha me kapacitet më të lartë për profilizim zhvillimor rajonal, e cila reflekton më mirë realitetin demografik dhe ekonomik të vendit dhe mundëson një koordinim më efektiv të politikave të zhvillimit rajonal, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial. Në këtë kuadër, synimi nuk është thjesht krijimi i rajoneve të barabarta nga pikëpamja demografike, por krijimi i rajoneve që organizohen në mënyrë që të mbështesin specializimin inteligjent, diferencimin funksional komplementar dhe zhvillimin e profileve zhvillimore rajonale të qarta e të zbatueshme në praktikë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni me rendin e brendshëm juridik. Projektvendimi është hartuar në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4 të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE

Projektvendimi nuk synon përafrimin me *Acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi përmban në dy krerë dhe pesë pika duke parashikuar rregullime specifike për secilën dispozitë, si vijon:

Kreu 1 parashikon ndryshimet dhe shtesat e propozuara në VKM nr.459 datë 30.07.2021 dhe përmban katër pika.

Pika 1, rregullon riorganizimin e Rajonit të Zhvillimit 2, duke përfshirë në këtë rajon bashkitë e qarkut Elbasan, si Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Gramsh, Cërrik, Peqin, Belsh. Ky riorganizim reflekton lidhjet e forta funksionale dhe ekonomike të këtyre bashkive me boshtin Tiranë–Durrës, aksesin e përmirësuar në infrastrukturë kombëtare rrugore dhe hekurudhore, orientimin e flukseve të punësimit, shërbimeve dhe tregtisë drejt zonës qendrore të vendit. Gjithashtu, përcaktohet zona metropolitane Tiranë–Kamëz si zonë me karakter të veçantë, për shkak të densitetit të lartë urban, rolit ekonomik dominues dhe nevojës për politika të diferencuara zhvillimi.

Pika 2, rregullon rikonfigurimin e Rajonit të Zhvillimit 3, duke përfshirë në këtë rajon bashkitë e jugut të brendshëm, Gjirokastër dhe bashkitë përreth, bashkitë e juglindjes të qarkut Korçë dhe të qarkut Berat. Rikonfigurimi krijon një rajon me karakter të qartë jugor dhe juglindor kontinental, rrit koherencën territoriale dhe kulturore, mundëson zhvillim të integruar të sektorëve si bujqësia, agroindustria dhe turizmi kulturor.

Pika 3, rregullon rishikimin e Rajonit të Zhvillimit 4, duke e fokusuar atë në zonën bregdetare dhe ultësirën perëndimore jugore, ku përfshihen qarqet Fier dhe Vlorë, si dhe bashkitë përkatëse. Ndryshimi kryesor konsiston në heqjen e bashkive të qarkut Gjirokastër nga ky rajon, duke e bërë atë më homogjen në aspektin gjeografik dhe ekonomik. Ky rikonfigurim forcon profilin e rajonit si një zonë me potencial të lartë në turizëm bregdetar, energji dhe bujqësi intensive si dhe lehtëson hartimin e politikave të dedikuara për zhvillimin e vijës bregdetare. *Pika 4*, përcakton hartën e rishikuar të rajoneve të zhvillimit që zëvendëson hartën në vendimin bazë dhe bëhet pjesë përbërëse e tij.

Kreu 2 përcakton që ngarkohen ministrinë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe subjektet e tjera përgjegjëse të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin për zbatimin e vendimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT

Vendimi do të zbatohet nga ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Projektvendimi është hartuar nga kabineti i Zëvendëskryeministrit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

ALBANA KOÇIU